



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT
TIRANË

Nr. Regj. Them. 6500/4066/355
Data e regjistrimit 21.01.2015

Vendimi Nr. 1106
Data e vendimit 16.03.2017

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit e përbërë nga Gjyqtarët :

BARI SHYTI	-	Kryesues
LINDITA SINANAJ	-	Anëtare
AMARILDO LAÇI	-	Anëtar

Asistuar nga sekretare [REDACTED] në Tiranë me datën 16.03.2017, përfundoi shqyrtimin në seancë gjyqësore publike, të çështjes administrative me Nr. 6500/4066/355 Regjistri Themeltar me palë ndërgjyqëse:

PADITËS: [REDACTED] e datëlindjes [REDACTED], lindur dhe banuese në [REDACTED]

I PADITUR: Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

PËRSON I TRETË: 1. Ministria e Drejtësisë.
2. Komisioneri Për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

OBJEKTI: 1. Konstatimi i diskriminimit, ndreqjen e shkeljes së ligjit, shpërblim i dëmit material dhe moral.
2. Të detyrohet Këshilli i Lartë i Drejtësisë të marrë në shqyrtim kërkesën dhe të vendos emërimin e paditëses në detyrën e gjyqtares ne Gjykatën e Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nenet 15-18; Neni 17/5, neni 182/2 dhe 3, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë (miratuar me Ligjin Nr.

10019, datë 29/12/2008 dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 74/2012); Nenet 7/b, 15/dh, të Ligjit Nr. 49/2012 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative"; Nenet 420, 625, të Kodit Civil; Ligji Nr. 10221, datë 04/02/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" nenet 1, 5, 7/1, 2, 12, 13/34-38.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 7462, datë 17.12.2014 ka vendosur:

- *Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë.*
- *Konstatimi i diskriminimit për shkak të mosmarrjes në shqyrtim të kërkesës së palës paditëse nga ana e palës së paditur, Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- *Detyrimin e palës së paditur, Këshillit të Lartë të Drejtësisë të marrë në shqyrtim kërkesën e paditëses.*
- *Detyrimin e palës së paditur, Këshillit të Lartë të Drejtësisë të dëmshpërblejë moralisht paditësen në masën e 1 milion lekë, për shkak të konstatimit të diskriminimit.*
- *Përmbushja e detyrimit nga pala e paditur, Këshillit të Lartë të Drejtësisë në favor të paditëses do të bëhet në këtë mënyrë dhe në këto afate:
Shlyerja e plotë e detyrimit do të bëhet në dy këste brenda një periudhe 12 muaj nga momenti i fillimit të ekzekutimit:
Kësti i parë i përbërë nga 500 000 duhet të shlyhet brenda 6 muajve të parë nga momenti i ekzekutimit të këtij vendimi;
Kësti i dytë i përbërë nga 500 000 duhet të shlyhet brenda 6 muajve të dytë nga momenti i ekzekutimit të këtij vendimi.*
- *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palëve në masën e pranuar dhe të rrëzuar të kërkesë padisë.*

Kundër vendimit të mësipërm ka paraqitur ankim paditësja [redacted] dhe pala e paditur Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me anë të të cilit kërkonë: Paditësja pranimin e plotë të padisë, ndërsa pala e paditur rrëzimin e padisë.

Paditësja ka parashtruar këto shkaqe për ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë.

- ✓ *Vendimin e shkallës së parë për pjesën që ka vendosur pranimin e padisë e konsiderojmë të bazuar në prova e në ligj, ndërsa për pjesën tjetër që ka vendosur rrëzimin e padisë vendimi është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit, prandaj duhet të ndryshohet duke vendosur përfundimisht pranimin tërësisht të padisë.*
- ✓ *Gjykata e shkallës së parë ka konkluduar që kërkimi për detyrimin e palës së paditur të vendosë emërimin e paditëses në detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Tiranë është një kërkim tërësisht në kundërshtim me ligjin, pasi ajo i kalon kufijtë shqyrtimit të çështjes dhe të mosmarrëveshjes objekt verifikimi.*

- ✓ Këtë përfundim të arritur nga gjykata e shkallës së parë e konsiderojmë kontradiktor me konkluzionet e tjera, atë për të drejtën "ipso lege" të paditëses për t'u rikthyer në vendin e mëparshëm të punës si gjyqtare e Apelit Tiranë, pas mbarimit ligjërisht të mandatit si anëtare e KQZ-së, si dhe me atë të konstatimit të diskriminimit të saj nga KLD-ja, si rezultat i mosshqyrtimit pa ndonjë shkak të përligjur të kërkesës së saj për realizimin e kësaj të drejte.
- ✓ Referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese vendimi për këtë pjesë nuk konsiderohet i arsyetuar në mënyrë të përshtatshme. Njëkohësisht ky vendim për këtë pjesë duhet të konsiderohet rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të normave kushtetuese e ligjore dhe të praktikës gjyqësore.
- ✓ Ndryshe nga sa konkludon gjykata, shkak i padisë nuk është thjesht mosmarrja e veprimit administrativ për marrjen në shqyrtim të kërkesës së paditëses, por pikërisht mosmarrja e një vendimi pozitiv nga KLD-ja për ta rikthyer atë në detyrën e mëparshme si gjyqtare e Apelit Tiranë. Ashtu siç shprehet me të drejtë gjykata në këtë vendim, e drejta e paditëses, që ka lindur menjëherë pas mbarimit ligjërisht të mandatit të saj si anëtare e KQZ-së, është një e drejtë që buron drejtpërdrejtë nga ligji, dhe detyrimi i KLD-së nuk është thjesht marrja në shqyrtim e kërkesës dhe dalja me një vendim për pranimin ose jo të kërkesës së paditëses gjatë procedurës së shqyrtimit të të gjitha kërkesave të tjera, por vetëm verifikimi nëse në Gjykatën e Apelit Tiranë kishte apo jo vende bosh. Duke qenë se gjatë gjithë kohës dhe aktualisht në atë gjykatë ka ende vende bosh për gjyqtarë, mosmarrja në shqyrtim e kërkesës dhe rrjedhimisht mosriemërimi i paditëses përbën një shkelje të hapur të ligjit, pasojë e së cilës nuk është vetëm shkaktimi i një dëmi moral, por edhe e një dëmi material. KLD-ja në përmbushje të detyrimit për shqyrtimin e kërkesës së përsëritur disa herë nga paditësja kishte vetëm të drejtën të verifikonte nëse në ndonjë moment të mëvonshëm do të kishte ndonjë shkak ligjor për mbarimin e mandatit si gjyqtare për paditësen, si p.sh. plotësimi i moshës për të dalë në pension, shkaqe që janë lehtësisht të verifikueshme dhe që nuk u pretenduan e nuk u ngritën në formë prapësimi nga pala e paditur gjatë gjykimit.
- ✓ Gjykata ka kompetencë ta detyrojë KLD-në ta marrë në shqyrtim kërkesën e paditëses dhe nuk ka të drejtë të marrë vetë një vendim për emërimin saj, por mosemërimi i paditëses në rrethanat që nuk ekziston ndonjë arsye e përligjur për të vendosur mosemërimin përbën një shkelje të të drejtës së saj që buron nga Kushtetuta dhe nga ligji dhe rrjedhimisht i shkakton asaj edhe një dëm material (diferenca e pagës së papërfutuar si gjyqtare apeli). Theksojmë se e drejta e paditëses buron drejtpërdrejtë nga Kushtetuta (neni 138), sepse koha e ushtrimit të funksionit si antare e KQZ-së (një funksion quasi gjyqësor) nuk përbën humbje të mandatit si gjyqtare apeli, por thjesht ndërprerje të përkohshme të ushtrimit të këtij mandati, deri në përfundimin ligjërisht të mandatit si anëtare e KQZ-së. Një argument më tepër për sa konkludojmë më lart është edhe fakti që antare e KQZ-së në fillim të mandatit të parë paditësja është emëruar nga KLD-ja.
- ✓ Shqyrtimi në një moment të dytë i kërimit të paditëses për dëm material, pasi KLD-ja të përmbushë detyrimin ligjor për të marrë në shqyrtim kërkesat e përsëritura të paditëses

- për t'u riemëruar në detyrën e gjyqtarës së Apelit dhe të dalë me një vendim për pranimin ose jo të këtij kërkimi, që përbën një detyrim që buron drejtpërdrejtë nga ligji dhe nuk është në diskrecionin e KLD-së, do të konsiderohej një mjet juridik jo efektiv në kuptim të KEDNJ dhe të jurisprudences së GJEDNJ, si dhe do të shkaktonte thjesht zvarritje të pajustificuar të procedurave administrative dhe gjyqësore të shqyrtimit të çështjes.
- ✓ Vendimi i shkallës së parë është haptazi rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit për pjesën që është vendosur rrëzimi i kërimit për dëmin material për periudhën e qëndrimit pa punë pas mbarimit të përligjur të mandatit si antare e KQZ-së.
 - ✓ Gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundime të gabuara faktike e ligjore lidhur me kërkimin për shpërblimin e dëmit material të shkaktuar paditëses si rrjedhojë e mosmarrjes në shqyrtim dhe mosrealizimin e së drejtës së saj për rikthimin në vendin e mëparshëm të punës si gjyqtare e Gjykatës së Apelit Tiranë.
 - ✓ Bazuar në argumentat e paraqitura përsa i përket përket kundërshtimit të përfundimit të arritur nga gjykata, sipas të cilës kërkimi për detyrimin e palës së paditur që të vendosë emërimin (riemërimin) e paditëses në detyrën e gjyqtarës së Apelit Tiranë është një kërkim në kundërshtim me ligjin, konkludohet se paditësja duhej të ishte emëruar menjëherë në detyrën e mëparshme si gjyqtare pas mbarimit të mandatit të saj si antare e KQZ-së.
 - ✓ Në rast të mospasjes së vendeve vakante në Gjykatën e Apelit Tiranë, ajo duhej të emërohej në një gjykatë tjetër apeli, ose në pamundësi të këtij opsioni, në një detyrë tjetër të përafërt, por gjykimi provoi se në vazhdimësi ka pasur vende bosh në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe se edhe aktualisht vazhdon të ketë vende bosh në atë gjykatë. Për rrjedhojë, nga mosriemërimi pa shkak të përligjur në detyrën e gjyqtarës së apelit paditësja ka pësuar një dëm të llogaritur në shumën prej 1.834.980 lekë, që përbën diferencën midis shumës së pagave që do të kishte përfituar deri në kohën e ngritjes së padisë dhe shumave të përfituara në këtë periudhë si përfitime që rrjedhin drejtpërdrejtë nga ligji. Ky është një dëm efektiv, i kundërligjshëm dhe rrjedhojë e drejtpërdrejtë e mosveprimit të palës së paditur për të përmbushur një detyrim që buron drejtpërdrejtë nga ligji. Përsa i përket elementit faj të përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, i takonte palës së paditur barra e provës për të provuar mungesën e dashjes apo të pakujdesisë së rëndë në formën e neglizhencës, gjë që as nuk e ka pretenduar në gjykim.

Pala e paditur, ka parashtruar këto shkaqe për ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë.

- ✓ Vendimi është i pabazuar në ligj dhe në prova sa i përket zgjidhjes në themel të çështjes.
- ✓ Pranimi nga ana e gjykatës i diskriminimit për shkak të mosmarrjes në shqyrtim të kërkesës së palës paditëse nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nuk është i bazuar në ligj, pasi në nenin 1, të Ligjit Nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" parashikohet se: "*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike,*

aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër". Sipas nenit 3 të këtij ligji, "Diskriminimi është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi".

- ✓ Për sa më sipër, gjykata në vendim nuk ka përcaktuar cili ka qenë shkaku që paditësja ka pretenduar se ndihet e diskriminuar. Gjithashtu nuk është përcaktuar në vendim se cilat janë provat që kanë krijuar bindjen për gjykatën se diskriminimi është kryer për një nga shkaqet e njohura dhe të pranura nga ligji.
- ✓ Garancia ligjore për anëtarin e KQZ-së shtrihet pa kufizim në kohë ndaj antarit aktual, pavarësisht pozicioneve shtetërore që ai ka patur, duke ia lënë atij në dorë të zgjedhë pozicionin që do të kthehet, pra është automatike për çdo antar që është në detyrë në kohën e miratimit të ligjit. Kjo do të thotë se në kohën e zgjedhjes së saj në detyrën e antares së KQZ-së, Kodi Zgjedhor nuk ka ofruar asnjë garanci për rikthimin e saj në pozicionin e gjyqtarës pas mbarimit të këtij mandati.
- ✓ Pretendimi i ngritur nga paditësja se ruan statusin e gjyqtarës është i pabazuar, pasi nuk ka asnjë normë kushtetuese apo ligjore që detyrën e gjyqtarit ta konsiderojë si titull të përjetshëm të tillë që me fitimin e tij, ai nuk humbet asnjëherë. Në të kundërt, funksioni i gjyqtarit është një detyrë profesionale që i nënshtrohet procesit të rekrutimit administrativ sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktura në mënyrë rigorozë nga ligji. Nuk mund të mendohet ruajtja automatike e cilësisë së gjyqtarit pa ushtruar detyrën e gjyqtarit. Kthimi i paditëses në detyrën e mëparshme të gjyqtarës nuk mund të bëhet automatike sepse paditësja [REDAKTUAR] nuk e gëzon më statusin e gjyqtarës, të cilin e ka lënë për të ushtruar një funksion tjetër shtetëror, siç është ai i antares së Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.
- ✓ Sigurisht, që pala paditëse ka patur të drejtë të kandidojë ligjërisht si gjithë gjyqtarët e tjerë të sistemit gjyqësor, për një vend të caktuar për gjyqtar të shpallur vakant me vendim të KLD-së, por kërkesa e saj duhet të ndjekë rrugën ligjore të parashikuar nga legjislacioni aktual, siç është paraqitja e kërkesës përkatëse, nënshtrimi kësaj kërkesë analizimit nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim nga KLD-ja për vlerësimin dhe pikëzimin e këtyre kandidaturave, paraqitja e rezultateve KLD-së dhe së fundmi, marrja në shqyrtim dhe votimi i çdo kandidature në mbledhjen përkatëse të KLD-së, duke u shpallur edhe fituesit përkatës.
- ✓ Në lidhje me këtë, të tre kërkesat e zakonshme të paditëses [REDAKTUAR] për t'u emëruar si gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë janë depozituar në KLD jashtë afatit të përcaktuar për të depozituar kërkesat përkatëse. Nën këtë arsyetim, paditëses [REDAKTUAR] në asnjë moment nuk i është cënuar e drejta e saj ligjore për të hyrë në kandidim të lirë për emërimin në një vend vakant për gjyqtar, ashtu sikundër edhe është fakt se kjo paditëse nuk është

votuar nga KLD për këtë vend vakant, për shkak se kërkesat e saj kanë qenë jashtë afatit ligjor.

- ✓ Gjithashtu përcaktimi në vendim nga ana e gjykatës, të natyrës specifike dhe krejtësisht të veçantë të paditëses dhe të kërkesës së saj drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përbën një kapërcim tej normave ligjore të parashikuara për një kandidat për gjyqtar në Gjykatën e Apelit, pasi edhe se kishte përfunduar mandatin si anëtare e KQZ-së, paditësja duhet të respektonte afatin e paraqitjes së kërkesës në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.
- ✓ Po kështu, argumenti teknik i përdorur në vendim për pranimin e diskriminimit të paditëses, është tërësisht i pathemeltë, pasi përdorimi i teknikës së analogjisë lejohet vetëm kur rregullat e procedurës mungojnë, që në rastin konkret nuk është e vërtetë. Legjislacioni parësor dhe sekondar mbi procedurat e emërimit, transferimit, rekrutimit të gjyqtarëve është tërësisht i plotë nga pikëpamja e procedurës. Nga ana tjetër, pavarësisht të metave në argument që lidhen me përdorimin e analogjisë në një rast ku rregullat e procedurës nuk mungojnë, duhet thënë se analogjia e përdorur është tërësisht e pavend. Është e vërtetë që KLD ka propozuar tek Presidenti i i Republikës për të emëruar në detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjyqtarin [REDAKTUAR] por diferenca midis rasteve qëndron në mënyrën e ndryshme të emërimit të këtyre dy gjyqtarëve në pozicionin e anëtarit të KQZ-së. Konkretisht, gjyqtari [REDAKTUAR] në ndryshim nga paditësja, është zgjedhur në këtë detyrë nën regjimin procedural të Kodit Zgjedhor, i miratuar me Ligjin Nr.10 019, datë 29.12.2008 dhe i ndryshuar me Ligjin Nr.74/2012. Për pasojë, procedura e emërimit të tij është bazuar tërësisht në nenin 17, pika 5, i Kodit Zgjedhor aktual, sipas të cilit pas mbarimit të funksionit, anëtari i KQZ-së rikthehet në funksionin publik të mëparshëm.
- ✓ Detyrimi nga ana e gjykatës për dëmshpërblimin moral të paditëses dhe masën e këtij dëmshpërblimi nuk është i bazuar në prova, pasi tabloja psikologjike e paraqitur në gjykatë nga paditësja dhe raporti psikologjik i paraqitur nga psikologja nuk përbëjnë prova, por janë përfundime tepër subjektive që nuk duhet të ishin marrë në konsideratë nga gjykata. Në hartimin e këtij raporti psikologjik ka mungesë të theksuar metodologjie dhe të teknikave shkencore, pasi jo vetëm që nuk përcaktohen saktë shkalla e ndikimit të stresit të përmendur në organizmin e paditëses, por nuk referohet as shkalla e vlerësimit të përdorur lidhur me pasojat e pretenduara.
- ✓ Zonja [REDAKTUAR] që ka hartuar Raportin psikologjik ndaj paditëses [REDAKTUAR] nuk është eksperte siç përcakton gjykata në vendim, pasi ajo nuk është e licensuar si e tillë dhe për këtë shkak raporti i përpiluar prej saj nuk duhet të konsiderohej nga gjykata akt ekspertimi.
- ✓ Detyrimi për nxjerrjen nga KLD-ja të aktit administrativ është i pabazuar në ligj, pasi gjykata nuk mundet të detyrojë organin administrativ, të marrë një vendim për një çështje. KLD nuk i ka marrë në shqyrtim kërkesat e paraqitura nga paditësja, pasi ato kanë qenë jashtë afatit ligjor për paraqitjen e kërkesave për plotësimin e vendeve vakante. Në këto kushte asnjë gjykatë nuk mund të detyrojë një organ të caktuar administrativ (aq më tepër

një organ kolegjal ku vendimi merret me shumicë votash) të marrë një vendim, të nxjerrë një akt administrativ sipas vullnetit të një pale të caktuar. Caktimi i një detyrimi të tillë nga gjykata administrative, çënon jo vetëm parimet kushtetuese të funksionimit të institucioneve të pavarura, por shkel edhe parimet e gjykimit administrativ të vendosura në Ligjin Nr. 49/2012.

- ✓ Në vendim konstatohen shkelje të rënda procedurale civile. Megjithëse paditësja në objektin e kërkesë padisë kishte kërkuar: Konstatimin e diskriminimit dhe ndreqjen e shkeljes së ligjit shpërblim dëmi material e moral dhe të detyrohet Këshilli i Lartë i Drejtësisë të marrë në shqyrtim kërkesën dhe të vendosë emërimin e paditëses në detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Tiranë, gjykata në kundërshtim me kërkesat e nenit 6, të Kodit të Procedurës Civile ku përcaktohet se: *“Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet”*, nuk është shprehur në dispozitivin e vendimit lidhur me dëmin material të kërkuar nga paditësja dhe lidhur me kërkesën për të detyruar Këshillin e Lartë të Drejtësisë të vendosë emërimin e saj në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Gjykata Administrative e Apelit, si dëgjoi relatimin çështjes nga gjyqtari Bari Shyti, analizoi shkaqet e ankimit dhe bisedoi në tërësi çështjen :

V Ë R E N

Se vendimi Nr. 7462, datë 17.12.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit material, për rrjedhojë duhet të ndryshohet nga Gjykata Administrative e Apelit.

I. Rrethanat e çështjes

Nga aktet shkresore që përmban fashikulli i gjykimit dhe parashtrimet e palëve ndërgjyqëse në seancë gjyqësore gjatë gjykimit në shkallë të parë, rezultojnë këto fakte:

Paditësja [REDAKTUAR] me vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 3, datë 23.02.1993, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë. Me vendimin nr. 146, datë 04.09.2003, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është vendosur zgjedhja e paditëses në detyrën e anëtares së Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve me një mandat 7 vjeçar. Në këtë kohë në fuqi ka qenë Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr. 9087, datë 19.06.2003. Përgjatë ushtrimit të këtij mandati, ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i cili sillte si pasojë ligjore ndërprerjen para kohe të mandatit të paditëses si anëtare e KQZ.

Duke respektuar dhe kushtet e reja ligjore paditësja në datën 02.02.2009, është rizgjedhur tashmë nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë anëtare e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ), detyrë të cilën e ka ushtruar deri në Tetor të vitit 2012, kohë në të cilën i përfundon mandati si anëtare e KQZ-se.

Mbas këtij momenti paditësja rezulton t'i jetë drejtuar tre herë palës së paditur Këshilli i Lartë i Drejtësisë për t'u rikthyer në pozicionin që ajo ka mbajtur para kohës së emërimit të saj në detyrën e antarit të KQZ, gjyqtare në Gjykatën e Apelit. Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) nuk i ka marrë asnjëherë në shqyrtim këto kërkesa të paditëses. Ndërkohë, gjatë kohës së parashtrimit të kërkesave nga paditësja, rezulton që janë shpallura nga pala e paditur Këshilli i Lartë i Drejtësisë vende vakante pikërisht për emërimë në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit. Pra nga koha e paraqitjes së kërkesës për t'u rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës, nga pala paditëse pranë palës së paditur, deri në paraqitjen për gjykim të kërkesë padisë provohet dhe pranohet se nga pala e paditur janë bërë emërimë në Gjykatën e Apelit. Në të njëjtën kohë rezulton se Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka marrë në shqyrtim kërkesa edhe të ish anëtarëve të KQZ për rikthim e tyre në detyrat që ata kanë ushtruar para fillimit të emërimit dhe të ushtrimit të mandatit si anëtarë të KQZ -së.

E ndodhur në këto kushte ku kërkesa e saj nuk është marrë asnjëherë në shqyrtim nga pala e paditur KLD, për rivendosjen e të drejtës së cenuar nga mosmarrja në shqyrtim të kërkesave të saj, me datë 09.09.2014, paditësja i është drejtuar gjykatës me kërkesë padinë objekt gjykimi.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pasi ka shqyrtuar çështjen, ka pranuar pjesërisht kërkesë padinë duke arsyetuar ndër të tjera se: Nga rrethanat e faktit dhe nga analiza ligjore Gjykata cmon se kërkimet e paditëses [REDAKTUAR], janë pjesërisht të hazuara në ligj dhe në prova.

Cilësia që gëzon paditësja në paraqitjen e kërkesës dhe kërkitimi për detyrimin e palës së paditur të marrë në shqyrtim kërkesën.

Paditësja ka paraqitur kërkesën pranë palës së paditur KLD me cilësinë dhe të drejtat që ajo mbart nga statusi që ajo kishte në kohën e paraqitjes së kërkesës, si ish gjyqtare e Gjykatës së Apelit, e emëruar dhe e mandatuar si anëtare e KQZ, pasi ka përfunduar këtë mandat. Çfarë do të thotë që dhe trajtimi i kërkesës së saj nga pala e paditur KLD duhej të bëhej në përgjigje të kësaj cilësie që paditësja mbarte në kohën e paraqitjes së kërkesës së saj.

Pikërisht në kohën që paditësja ka përfunduar mandatin e saj si antare e KQZ, në fuqi ka qënë Ligji Nr.10 019, datë 29.12.2008, Kodi Zgjedhor. Ky ligj në mënyrë të shprehur, pa ekuivoke parashikon se pas mbarimit të funksionit, anëtari i KQZ-së rikthehet në funksionin publik të mëparshëm dhe kur kjo nuk është e mundur, në një vend të të njëjtit nivel në organet e administratës publike. Ky nen është i emërtuar dhe normon të drejtat dhe detyrat e antarit të KQZ. Pra anëtari i KQZ-së, për shkak të këtij ligji ka këtë të drejtë të parashtojë këtë kërkesë. Kjo do të thotë se paditësja në paraqitjen e kërkesës së saj pranë palës së paditur ka ushtruar pikërisht këtë të drejtë të saj ligjore si ish antare e KQZ-së në përfundimin e mandatit të saj. Nga vet përmbajtja e këtij kuadri ligjor rezulton se Kodi Zgjedhor nuk parashikon limit, kohë dhe afat brenda të cilit kjo kërkesë duhet të paraqitet pranë organit që menaxhon funksionin publik që ajo

ka patur para fillimit të cilësisë së saj, si antare e KQZ-së. Si rrjedhojë, prapësimi se pala paditëse e ka paraqitur kërkesën jashtë afateve të lejuara për aplikim/konkurim nuk është i bazuar në ligj. Pala e paditur në kuadër të prapësimit të saj në lidhje me këtë moment prapësoi edhe Lidhur me faktin se paditësja nuk e gëzon këtë cilësi të vecantë për shkak se emërimi i saj është bërë në një kohë që në fuqi nuk ka qenë parashikimi ligjor se pas mbarimit të funksionit, antari i KQZ-së rikthehet në funksionin publik të mëparshëm dhe kur kjo nuk është e mundur, në një vend të të njëjtit nivel në organet e administratës publike.

Gjykata konkludon se fakti i prapësuar nga pala e paditur është i vërtetë, pasi kjo rezultoi nga një interpretim historik i kuadrit ligjor prej të cilit buron e drejta e paditëses, Kodit Zgjedhor. Në kohën që paditësja është emëruar ligji në lidhje me këtë të drejtë nuk ka patur këtë formulim. Por gjykata cmon se edhe ky prapësim i palës së paditur nuk qëndron pasi në përfundim të mandatit të paditëses në fuqi ka qenë parashikimi ligjor se pas mbarimit të funksionit, anëtari i KQZ-së rikthehet në funksionin publik të mëparshëm dhe kur kjo nuk është e mundur, në një vend të njëjtit nivel në organet e administratës publike. Në interpretimin e gjykatës paditësja në përfundim të mandatit absolutisht për shkak të parashikimit aktual të ligjit të kohës së mbarimit të mandatit të saj, ajo e ka gëzuar këtë të drejtë. Vetë Kodi Zgjedhor nuk bën dallim në lidhje me gëzimin e kësaj të drejte në raport me kushtet dhe kriteret dhe kohën e rekrutimit të antarëve të KQZ-së. Në përfundim të mandatit të saj paditësja e ka patur absolutisht dhe pa diskutim këtë cilësi dhe interpretimi i të kundërtës nuk gjen mbështetje në ligj. Gjithashtu në lidhje me këtë moment gjykata thekson edhe faktin se edhe ligji i kohës së fillimit të cilësisë së paditëses, si antare e KQZ - së ka bërë një parashikim për të garantuar të drejtat e antarëve të KQZ-së. Respektivisht në nenin 23/3, të Ligjit Nr.9087, datë 19.6.2003 normon se paga dhe privilegjet e antarit të KQZ-së janë të njëjtu me pagën dhe privilegjet e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Kjo dispozitë ka karakter referues tek një tjetër normë dhe kuadri ligjor përkatësisht në ligjin e kohës për Gjykatën e Lartë dhe në atë c`ku ky ligj parashikon për privilegjet e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Përkatësisht në ligjin për Gjykatën e Lartë, në kreun II është i normuar statusi i Gjyqtarit të Gjykatës së Lartë (sipas parashikimit të kohës). Respektivisht në nenin 23 të tij është parashikuar me plotësimin e mandatit, sipas kushteve të parashikuara në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës, gjyqtari i Gjykatës së Lartë, me kërkesën e tij, emërohet gjyqtar në gjykatën e apelit. Pra duke patur parasysh edhe këtë parashikim të kohës pala paditëse e ka gëzuar këtë të drejtë që në kohën që ajo është mandatuuar si antare e KQZ së.

Si rrjedhojë sa më lart, kërkitimi i paditëses për detyrimin e palës së paditur të marrë në shqyrtim kërkesën e palës paditëse është një kërkitim i mbështur si në ligj edhe në prova.

Kërkitimi i paditëses për detyrimin e palës së paditur të vendos emërimin e paditëses në detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Gjykata pasi u njoh me këtë kërkitim konkludon se ky është një kërkitim tërësisht në kundërshtim me ligjin, pasi ajo i kalon kufijtë shqyrtimit të çështjes dhe të mosmarrëveshjes objekt verifikimi. Thelbi i padisë së palës paditëse është detyrimi i palës së paditur të kryejë një veprim administrativ, marrjen në shqyrtim të kërkesës së saj dhe ky kërkitim u konsiderua nga gjykata i drejtë. Por kërkitimi për detyrimin e palës së paditur që jo vetëm të marrë në shqyrtim, por të vendos ashtu si kjo palë kërkon është në kundërshtim me atë c`ka kuadri ligjor në fuqi parashikon. Respektivisht në ligjin për organizimin dhe funksionimin e KLD janë të parashikuar të gjithu kompetencat/ të drejtat/ detyrat e këtij organi administrativ. Gjykata cmon se në rast se në këtë gjykim kërkohet marrja në shqyrtim dhe për rrjedhojë dhe nxjerrja e një vendimi nga ky organ publik në kushtet kur pa një shkak ligjor ky organ nuk ka vepruar nuk mund të interpretohet edhe në përcaktimin e llojit të aktit që duhet të nxjerrë apo nxirrte ky organ publik. Lloji i vendimarrjes

që do të thotë dhe lloj i aktit të palës së paditur është një e drejtë ekskluzive e organit publik palë të paditur për aq kohë sa në zbatim të nenit 67, të Ligjit 49/2012 nuk kemi ende një vendim detyrues për nxjerrjen e një akti administrativ në favor të palës paditëse.

Pra gjykata lidhur me këtë kërkim të palës paditëse konkludon se paditësja nuk ka shkak ligjor në ngritjen e këtij pretendimi. Nga asnjë dispozitë ligjore nuk lind e drejta palës paditëse për të shmangur shqyrtimin administrativisht të çështjes nga vet organi/palë e paditur që ka kompetencën ligjore për të shqyrtuar këtë çështje dhe për të dhënë mendimin edhe vullnetin e tij administrativ për këtë çështje. Shkaku i paraqitjes së kësaj padie në gjykatë parashtrohet dhe rezulton të jetë moskryerja e veprimit administrativ të marrjes në shqyrtim të kërkesës së paditëses dhe jo mosmarrja e një vendimi pozitiv nga pala e paditur në favor të paditëses.

Për të gjitha sa më lart, gjykata konkludon se ky kërkim i palës paditëse është i pambështetur në ligj dhe si i tillë ai rrëzohet nga gjykata.

Kërkimi i palës paditëse për konstatimin e diskriminimit si rezultat i mosshqyrtimit të kërkesës së saj nga pala e paditur KLD.

Lidhur me thelbin e këtij kërkitimi pala paditëse pretendon se në rastin e saj jemi para diskriminimit, pasi KLD në dy raste analoge të ngjashme nuk ka zbatuar ligjin njësoj, që do të thotë në rastin e paditëses nuk është bërë trajtim i barabartë por një trajtim i pafavorshëm. Respektivisht pala paditëse i referohet faktit, se në të njëjtën kohë që kërkesa e saj nuk merret në shqyrtim nga KLD në rastin e [REDAKTUAR] pala e paditur KLD ka vepruar ndryshe. Respektivisht në rastin e [REDAKTUAR] KLD ka marrë në shqyrtim kërkesën dhe ka vendimarrje konkrete ndaj kërkesës së tij, në një kohë që në rastin e paditëses nuk e ka marrë fare në shqyrtim kërkesën dhe nuk ka përgjigje prej saj lidhur me kërkesat e paraqitura nga pala e paditur.

Duke patur parasysh sa më lart, gjykata konkludoi se paditësja e gëzon të drejtën për të kërkuar rikthimin në statusin e saj të mëparshëm në Gjykatën e Apelit me cilësinë e saj si ish antare e KQZ-së, atëherë situata apo rasti i paditëses me rastin e subjektit [REDAKTUAR] është identik. Si rrjedhojë në vazhdim të logjikës së argumentimit rezulton se qëndrimi i palës së paditur në raport me dy kërkesa të karakterizuara nga kushte dhe kriteret ligjore të njëjta dhe situatë identike është i ndryshëm. Në një rast e merr në shqyrtim në një rast ajo nuk e merr në shqyrtim.

Prapësimi tjetër i palës së paditur lidhur me këtë moment është edhe fakti se sipas palës së paditur paditësja në cdo rast duhet të parashtrorë dhe të provojë ekzistencën e shkakut të diskriminimit. Pra po sipas palës së paditur pala paditëse kishte detyrimin ligjor për të parashtruar shkakun e këtij diskrimi.

Lidhur me këtë prapësim gjykata ndalet në dy momente, është tjetër gjë të identifikosh shkakun e diskriminimit, gjë të cilën pala paditëse e ka bërë në rastin konkret, dhe tjetër moment procedural harra e provës që i përgjigjet nëse ka apo jo diskriminim.

Në rastin e parë pala paditëse pretendon se shkak janë bindjet politike. Pala paditëse konkludon në këtë mënyrë duke vlerësuar faktin se ajo në KQZ dhe në pozicionin e mbajtur prej saj në këtë strukturë ka apo personifikon një ngjyrë politike. Në këtë kuadër paditësja ka dyshimin se kjo situatë trajtuese jo e njëllajtë është i lidhur me këtë moment dhe nuk shpjegohet në kuptim të ligjit nga pala e paditur.

Por lidhur me barrën e provës gjykata konkludon se ky moment është i normuar në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi në nenin 36/5, 6 të tij. Sipas këtij kuadri ligjor paditësi ka detyrim të sjellë prova në mbështetje të padisë, duke përdorur çdo lloj prove të ligjshme që mund të provojë sjelljen diskriminuese. Ky është moment deciziv pasi në rastin konkret nga përcaktimi dhe interpretimi i fakteve në mënyrë të pavarur nga qëndrimi i palëve, por në përputhje të plotë me ligjin gjykata konkludoi se rastet e parashtruara nga pala e paditëse janë analoge në raport me

atë çfarë synon ky gjykim. Pra trajtimi jo i barabartë në dy situata analoge është prezent dhe rezultoi i provuar.

Pasi paditësja paraqet prova, mbi të cilat bazon pretendimin e saj dhe në bazë të të cilave gjykata mund të prezumojë sjelljen diskriminuese, i padituri detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim sipas këtij ligji. Pra ishte detyrimi i palës së paditur të provonte se në rastin konkret nuk jemi para diskrimimit.

Pala e paditur ishte e detyruar që të provonte se trajtimi i ndryshëm ndërmjet rastit të paditëses dhe subjektit ndjek qëllime të ligjshme. Pala e paditur jo vetëm që nuk e provoi këtë fakt, por nuk pranoi se ishte para rastit të trajtimit jo të njëjtë për atë çfarë është vlefshme në këtë gjykim pavarësisht faktit se kuadri ligjor parshikon të kundërtën dhe gjykata konkludoi për të kundërtën. Si rrjedhojë e këtij argumenti gjykata konkludon se në kushtet kur u provua se për shkak të ligjit situata e paditësit në paraqitjen e kërkesës pranë palës së paditur KLD është identike me situatën e dhe pala e paditur nuk provoi pse ishte ky diferencim në trajtimin e kërkesave nga pala e paditur dhe se ky diferencim kishte një shkak ligjor, atëherë gjykata konkludon se në rastin e paditëses konstatohet ekzistenca e disikrimimit të paditëses në rastin kur kërkesa e palës paditëse nuk është marrë në shqyrtim nga pala e paditur.

Në nenin 37, të këtij ligji parashikohet se në rast se gjykata konstaton diskriminim, cakton dëmshpërblim nëse vendos që ka shkelje të këtij ligji, duke përfshirë edhe një afat kohor për kryerjen e zhdëmtimit. Ndërkohë në nenin 38 të këtij ligji parashikohet se dëmshpërblimi përfshin ndër të tjera, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe të pasojave të tyre përmes kthimit në gjendjen e mëparshme, kompensimin e dukur për dëmet pasurore si dhe jopasurore, ose përmes masave të tjera të përshtatshme.

Në nenin 625/1/a, të Kodit Civil, parashikohet shprehimisht se: "Përsoni që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur: a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit, ose është cënuar në nderin e personalitetin e tij...".

Dëmi jo pasuror i parashikuar nga neni 625/1/a, i Kodit Civil, është një nga llojet e dëmit jashtëkontraktor, koncepti i të cilit jepet në nenet 608 dhe 609, të Kodit Civil.

Lidhur me këtë moment gjykata thekson se pala paditëse kërkon të dëmshpërblehet në dy forma të dëmit. Në dëmshpërblimin e një dëmi moral dhe në atë material

Lidhur me dëmin material pala paditëse duhet ta provojë humbjen e pësuar de facto në pasurinë e saj. Në lidhje me këtë moment pala paditëse i referohet faktit të mungesës së 1/2 të pagës që do të kishte përfituar nëse kërkesa do të ishte miratuar. Në kuadër të këtij kërkimi gjykata konkludon se në eventualitetin e këtij kërkimi, ky kërkim nuk gjen mbështetje në ligj, pasi nuk mund të pretendosh dëm material që rrjedh nga mosmarrja në shqyrtim e kërkesës, pasi kjo në asnjë rast nuk jep garanci që kërkesa do të pranohet apo është një kërkesë e drejtë.

Dëmi material nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me diskriminimin në situatën e konstatuar me mosmarrjen në shqyrtim të kërkesës. Marrja në shqyrtim e kërkesës nuk do të thotë pasojë të drejtpërdrejtë përfitimin e 1/2 së pagës. Pra në rastin konkret nuk provohet ardhja e një dëmi konkret faktik/ material nga qëndrimi i palës së paditur dhe për rrjedhojë gjykata konkludon se ky kërkim nuk qëndron. Pala paditëse jo vetëm që nuk provoi ardhjen e dëmit konkret në mënyrë të drejtpërdrejtë nga mosmarrja në shqyrtim e kërkesës, por ajo as nuk arriti ta prapësonte atë ashtu si ligji kërkon.

Ndërkohë në lidhje me pretendimin për dëmshpërblim moral gjykata konkludon dhe analizon kushtet e këtij kërkimi si më poshtë:

1. Ekzistenca e dëmit. Nga analiza e provave të marra në shqyrtim dhe nga piketat orientuese të caktuara me vendimin unifikues nr.12, datë 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara, Gjykata

Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vlerëson se paditësi në të vërtetë, ka pësuar një dëm që vjen si rezultat i diskriminimit të tij. Sa më lart nisur dhe nga prova me ekspert e marrë në gjykim, gjykata konkludoi se paditësja ka pësuar një dëm moral. Kjo është një gjendje fakti dhe e provuar në gjykim.

2. Kundraligjshmëria e dëmit. Në nenin 608/3, të Kodit Civil jepet kuptimi i dëmit të paligjshëm si vijon: "Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cënimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira". Në rastin konkret ky element i shkakimit të dëmit rezultoi i provuar në kuadër të shqyrtimit të padisë. Gjykata në kuadër të identifikimit të shkakut që ka sjellë këtë dëm tek paditësi është dakort që ky shkak është pikërisht mosmarrja në shqyrtim i kësaj kërkesë.

Lidhur me ekzistencën e dëmit moral dhe të masës së këtij dëmi, gjykata arsyeton: E gjithë ngjarja faktike nga paraqitja e kërkesës së parë pranë palës së paditur deri në kohën e gjykimit dhe të kryerjes së aktit të ekspertimit nga ekspertja konkludohet se ngjarja ka ndikuar negativisht në mirëqënien psiko - emocionale të paditëses si dhe ka ndikuar negativisht në disa aspekte të veprimtarisë së përditshme social - punësore. Po kështu nga ekspertja vlerësohet se marrëdhëniet ndërpersonale e familjare janë ndikuar nga ngjarja në fjalë si dhe vazhdojnë të ndikohen nga proceset gjyqësore që ajo ndjek duke bërë në këtë mënyrë që ngjarja të jetë pjesë e rutinës së përditshme personale dhe familjare. Për shkak të efektit Horn të shkakuar publiku ka tendencë të hejë përgjithësimet negative profesionale për individin bazuar në elementët e ngjarjes. Gjykata duke patur parasysht të gjitha sa më lartë cituar konkludon se masa e dëmshpërblimit në rastin objekt gjykimi do jetë në masën 1 (një) milion lekë.

I. VLERËSIMI I ÇËSHTJES NGA GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Me ankimin e palës paditëse [REDAKTUAR] dhe palës së paditur, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, kundër vendimit të cituar në pjesën hyrëse të këtij vendimi, çështja është regjistruar për gjykim në këtë gjykatë me date 21.01.2015. Duke ndjekur urdhërimet e nenit 49 e 51 të ligjit nr 49/2012, gjykimi i çështjes filloi në dhomë këshillimi, dhe përfundoi në seancë gjyqësore ku gjykata thirri palët për ti dëgjuar mbi pretendimet e tyre të ngritura në ankim me qëllim sqarimin e plotë të rrethanave faktike dhe ligjore, por megjithëse kishin dijeni rregullisht për datën dhe orën e seancës, asnjë nga palët nuk u paraqit. Gjykata nuk pranoi kërkesën e paraqitur nga paditësja për shtyrjen e seancës gjyqësore duke parashtruar si shkak, largimin e saj në SHBA para datës së seancës, pasi vlerësoi se paditësja kishte mundësi të përfaqësohej në gjykim nëpërmjet avokatit të caktuar prej saj por edhe për faktin se seanca gjyqësore kishte rreth një muaj që ishte shpallur duke i dhënë mundësi paditëses të merrte masa për të planifikuar udhëtimin e saj jashtë shtetit, e ushtruar në këtë mënyrë të drejtën për tu dëgjuar. Në këto rrethana, gjykata mori vendim bazuar në shkaqet e parashtruara në ankimet e palëve, parashtrimet e depozituara në sekretarinë e Gjykatës së Apelit para datës së seancës gjyqësore si dhe në aktet e administruara në dosjen gjyqësore.

Para se gjithash, është për tu theksuar fakti që, Gjykata Administrative e Apelit, investohet në shqyrtimin e ankimit dhe zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes, vetëm pasi sigurohet, se lënda e gjykimit është në kompetencë të saj, ankimi i plotëson kushtet e pranueshmërisë, dhe vendimi apo procedura e gjykimit në shkallë të parë vlerësohen të vlefshme. Në të kundërt sikurse

parashikon e drejta procedurale për gjykimet administrative, (nenet 13, 50/ç e 54 të L. 49/2012), Gjykata Administrative e Apelit vendos sipas rastit, mospranimin e ankimit, shpalljen e mos kompetencës apo prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes ose kthimin për rigjykim në shkallë të parë, duke sjellë si pasoje mos shqyrtimin në themel të çështjes.

Nga shqyrtimi *ex officio* i rrethanave si më sipër, ky kolegji nuk evidentoi pengesa procedurale për te vijuar gjykimin me analizën e shkaqeve të ankimit, e ndjekur në këtë mënyrë marrëdhënien fakt- ligj me qëllim zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes.

Referuar shkaqeve të parashtruara në ankim nga pala paditëse dhe pala e paditur, gjendjes në të cilën paraqiten rrethanat e çështjes, objektit dhe shkakut të padisë, vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe argumenteve të dhëna prej saj në përgjigje të pretendimeve të palëve, Gjykata Administrative e Apelit (këtu e ne vijim Gjykata e Apelit/kolegji), vlerëson se si ankimi i palës paditëse ashtu dhe ai i palës së paditur përmbajnë shkaqe për ndryshimin e vendimit, por as ankimi i paditëses nuk përmban shkaqe për pranimin e plotë të padisë, as ai i palës së paditur për rrëzimin të padisë në të gjitha kërkimet e saj.

Ky kolegji, vlerëson se Gjykata e Shkallës së parë, ka arritur të beje cilësimin e saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen më mosmarrëveshjen, duke identifikuar saktë shkakun e padisë e arritur në konkluzionin e drejtë se mosmarrja në shqyrtim nga ana e palës së paditur të kërkesës së paditëses përben cenim të të drejtës subjektive të paditëses për tu rikthyer në funksionin publik që kishte para mandatimit si anëtare e KQZ, e drejtë kjo e parashikuar nga ligji (Kodi Zgjedhor), por ka gabuar në interpretimin e dispozitave të të drejtës objektive me qëllim rivendosjen e të dëmtuarit nga mosveprimi i kundërligjshëm, në gjendjen e mëparshme "*statu quo ante*".

Sikurse rezulton nga rrethanat e faktit, me mbarimin e mandatit si anëtare e KQZ, në muajin tetor të vitit 2012, paditësja i është drejtuar palës së paditur me kërkesë për tu rikthyer ne funksionin publik të mëparshëm si gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë, kërkesë e cila është protokolluar pranë palës së paditur me datën 16.10.2012. Në këtë mënyrë paditësja ka ushtruar të drejtën e njohur nga Ligji, Kodi Zgjedhor, i miratuar me ligjin Nr. 10019/2008 i ndryshuar me ligjin nr 74/2012, i cili në nenin 17 pika 5 ka parashikuar pikërisht të drejtën e anëtarit të KQZ-së për tu rikthyer ne funksionin publik të mëparshëm pas mbarimit të funksionit. Nga kjo e drejtë, pra nga e drejta e rikthimit ne funksionin publik të mëparshëm, anëtarit të KQZ-së i buron e drejta e përfitimit të pagës së plotë të pagës referuese të funksionit, e parashikuar nga neni 7 paragrafi 6, i ligjit nr 8097/1999 "Për përfitimet shtetërore suplementare". Kërkesën drejtuar palës së paditur për rikthim në detyrën e gjyqtares së Apelit, paditësja e ka përsëritur edhe dy herë të tjera, por në asnjë rast pala e paditur nuk e ka marrë në shqyrtim atë.

Pikërisht ky mosveprim i palës së paditur, për mosdhënie përgjigje kërkesës së paditëses, përben edhe mosveprimin e kundërligjshëm, nga i cili paditësja ka pësuar edhe dem, për të cilin kërkon të dëmshpërblehet përmes padisë objekt gjykimi.

Në zbatim të nenit 51 të K.Pr. Administrative, paditësja gëzonte te drejtën për t'u informuar nga administrata publike palë e paditur, në lidhje me zhvillimin e procedimit për te cilat ajo është drejtpërdrejt e interesuar. Në kuptim të kësaj dispozite, rrjedh detyrimi i palës së paditur për të informuar paditësen për ecurinë e kërkesës së saj.

Paraqitja e kërkesës formale nga ana e paditëses angazhon organin publik palë e paditur, që në përputhje me rregullat e përcaktuara në Ligjin specifik që normon rregullat e organizimit dhe të funksionimit të KLD, dhe parimet e përgjithshme të procedimit administrativ, ndër të cilët, parimi i ligjshmërisë, i përgjegjshmërisë dhe i marrjes së vendimeve të ushtronte kompetencën ligjore për të marrë një vendim lidhur me këtë kërkesë të paditëses.

E drejta për informim dhe e drejta për dëmshpërblim për demet që ju shkaktohen individëve nga veprimet a mosveprimet e kundërligjshëm të administratës publike janë ngritur edhe në nivelin e të drejtave kushtetuese. Kushtetuta e RSH në nenet 23 e 44 të saj ka sanksionuar pikërisht detyrimin e organeve shtetërore të veprojnë në mënyrë aktive për çdo pretendim të individëve, që lidhen me të drejtat personale dhe pasurore të tyre.

Kështu në nenin 23 të kushtetutës parashikohet : *1. E drejta e informimit është e garantuar. 2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore*

Neni 44 i Kushtetutës ka parashikuar: Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.

Në zbatim të nenit 44 të Kushtetutës është miratuar edhe ligji Nr. 8510, datë 15.7.1999 "*Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore*". Sipas nenit 3 të ligjit Nr. 8510, datë 15.7.1999, organet e administratës shtetërore përgjigjen për demet që u shkaktojnë personave fizikë a juridikë privatë në rastet që vijojnë: a) *kur kryejnë veprime a mosveprime të kundërligjshme.*

Përkundrajt kërkesës së paditëses, për rikthim në funksionin e gjyqtarës në Gjykatën e Apelit Tiranë, referuar nenit 17/5 të K. Zgjedhor, pala e paditur kishte detyrimin ligjor të merrte në shqyrtim me përparësi kërkesën e paditëses dhe ta informonte atë brenda afateve të arsyeshme për pranimin ose jo të kërkesës, dhe arsyet e mospranimit në rast të refuzimit të kërkesës. Mosveprimi i palës së paditur për të marrë në shqyrtim kërkesën e paditëses, për më tepër mosdhënia e informacionit brenda një afati të arsyeshëm, përbën edhe mosveprimin e kundërligjshëm të palës së paditur, nga i cili paditësja ka pësuar dëm, ndërsa pala e paditur është përgjegjëse për dëmin e shkakuar asaj.

Gjykata e shkallës së parë, megjithëse ka konstatuar se, pas mbarimit të funksionit, anëtari i KQZ-së rikthehet në funksionin publik të mëparshëm dhe kur kjo nuk është e mundur, në një vend të të njëjtit nivel në organet e administratës publike dhe se prapësimi se pala paditëse e ka paraqitur kërkesën jashtë afateve të lejuara për aplikim/konkurim nuk është i bazuar në ligj, nuk ka zgjidhur mosmarrëveshjen dhe rivendosur te drejtën e cenuar të paditëses nga ky fakt i kundërligjshëm. Disponimi i gjykatës për detyrimin e palës së paditur të marrë në shqyrtim kërkesën e paditëses, nuk rivendos të drejtat e cenuara të të dëmtuarës nga mosveprimi i kundërligjshëm.

Në zbatim të nenit 17/2 të Ligjit nr 49/2012, gjykata zgjidh mosmarrëveshjet në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët.

Në zbatim të kësaj norme proceduralë, gjykata kishte detyrimin të zgjidhte mosmarrëveshjen duke rivendosur paditësen në atë gjendje pasurore që do të kishte nëse fakti i kundërligjshëm nuk do të kishte ndodhur. Pavarësisht mënyrës së formulimit të objektit të padisë, ajo c,ka rezulton nga përmbajtja e padisë, evidenton faktin se shkak i padisë ka qenë pikërisht humbja pasurore që paditësja ka pësuar nga mos emërimi në funksionin e gjyqtarës në Gjykatën e Apelit, nga e cila do të përfitonte pjesën e munguar të të ardhurave për shkak të funksionit që kishte si anëtarë e KQZ. Kjo është edhe e drejta e mbrojtur nga ligji zgjedhor dhe ligji për sigurimin suplementar të një kategorie të nëpunësve shtetëror, për të cilën paditësja ka kërkuar edhe mbrojtje gjyqësore përmes padisë drejtuar gjykatës.

Natyrisht që rivendosja e plotë e të drejtës së cenuar nga fakti i kundërligjshëm do të ishte e drejta e kthimit të paditëses në detyrën e gjyqtarës së Apelit, gëzimi i së cilës ishte pezulluar për shkak të mosveprimeve të palës së paditur, por duke qenë një e drejtë që nuk mund të rivendoset përmes padisë, për shkak të diskrecionit të organit publik në ushtrimin e kompetencës për propozimin para presidentit të Republikës për emërimin e paditëses në detyrën e gjyqtarës, e vetmja e drejtë që mund të rivendoset është ajo e dëmshpërblimit. Kjo do të thotë se pala e paditur do të shpërblejë humbjen e pësuar (*damnum emergens*), si rezultat i shkaktimit të dëmit. Vetëm, duke pranuar një sistem të tillë shpërblimi do të mund të themi se e kemi kthyer të dëmtuarin në gjendjen e mëparshme.

Neni 608/1 i Kodit Civil parashikon: "*Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar. Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj. Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cenimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rencli juridik ose nga zakonet e mira.*". Ndërsa në nenin 609 të K. Civile përcaktohet "*Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit.*

Nga interpretimi i kësaj norme të drejtës materiale, kuptohet se, për të ekzistuar marrëdhënia juridike e detyrimit që lind nga shkaktimi i dëmit jashtëkontraktor ne formën e dëmit pasuror apo të dëmit jo pasuror, duhet të konkurojnë njëkohësisht 4 elementet e figurës së dëmit. (i) ekzistenca e dëmit real ne pasurinë ose në shëndetin e personit; (ii) paligjshmëria e veprimit ose mosveprimit të të tretit; (iii) lidhja shkakësore midis veprimit ose mosveprimit dhe dëmit të ardhur dhe, (iv) fajësia e personit që ka shkaktuar dëmin. Mungesa, qoftë e njërit nga këto kushte, bën që të mos lindë detyrimi nga shkaktimi i dëmit.

Gjykata e Apelit mori në analizë 4 elementet e dëmit në raport me faktet e pretenduara nga paditësi se ajo ka pësuar një dëm në pasurinë e saj, dhe ky dëm është rrjedhojë e drejt për drejtë e mosveprimit të kundërligjshëm, të kryer me faj nga të paditurit.

Demi pasuror që ka pësuar paditësja, përbëhet nga diferenca e munguar e pagës që ajo do të kishte përfituar mbi pagën që përfiton për shkak të gëzimit të statusit si anëtare e KQZ për një periudhë 3 vjeçare nga ndërprerja e mandatit. Nëse paditësja do të ishte rivendosur në të drejtën e parashikuar nga neni 17/5 i K. Zgjedhor, në zbatim të nenit 7 paragrafi 6 i ligjit nr 8097/1999, ajo do të kishte përfituar kompensimin e pagës deri në nivelin e pagës referuese të funksionit si nënkryetare e KQZ-së për një periudhë 3 vjeçare. Ky afat përkon edhe me mbushjen e moshës për pension pleqërie të paditëses, për shkak të të cilës, shpërblimi në formën e pagës ndërpritet(neni7/7 i ligjit nr 8097). Diferenca ndërmjet pagës që paditësja përfiton në gëzim të statusit si nënkryetare e KQAZ, dhe pagës që do të kishte përfituar nëse do të ishte emëruar në detyrën e gjyqtarës së Apelit Tiranë përben edhe dëmin real që paditësja ka pësuar nga mosveprimi i palës së paditur.

Për sa më sipër, ky kolegji, vlerëson se padia e paditëses duhet të pranohet pjesërisht duke detyruar palën e paditur të dëmshpërblejë paditësen, për dëmin pasuror të shkaktuar, duke i kompensuar pagën mbi pagën e përfituar në zbatim të nenit 7 të ligjit nr 8097 dt 23.03.1996, deri në nivelin e pagës referuese të funksionit si nënkryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për periudhën 01.01.2013 – 01.01.2016

Sa i përket kërimit të paditëses për shpërblim dëmi moral, dem i cili pretendohet në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Gjykata e Apelit vlerëson se nga ky ligj paditëses nuk i buron asnjë e drejtë.

Sikundër me të drejtë ka pretenduar pala e paditur, pranimi nga ana e gjykatës së shkallës së parë i diskriminimit për shkak të mosmarrjes në shqyrtim të kërkesës së palës paditëse nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nuk është i bazuar në ligj. Në nenin 1, të Ligjit Nr.10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen

familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Asnjë nga rastet e parashikuara në këtë dispozitë nuk gjejnë zbatim në rastin e paditëses. I vetmi pretendim i paditëses si rrethanë diskriminuese, ka të bëjë me faktin se ajo në cilësinë e anëtares së KQZ-së ka përfaqësuar një subjekt politik të caktuar, për shkak të të cilës paditësja pretendon se nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë me subjekte të tjerë në kushte të njëjta apo të ngjashme.

Gjykata e Apelit, thekson se ky fakt do të përbente objekt diskutimi në raport me parashikimin e nenit 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, vetëm në rast se kërkesa e saj do të ishte marrë në shqyrtim nga pala e paditur dhe për shkak të përfaqësimit të saj politik në KQZ, pala e paditur do të kishte refuzuar kërkesën për rikthim në sistemin gjyqësor. Për sa kohë kërkesa e saj nuk është marrë në shqyrtim fare nga pala e paditur, nuk mund të vihet në diskutim cenimi i të drejtave që rrjedhin nga Ligji i lart cituar. Pikërisht ky fakt, pra mosveprimi i palës së paditur për të marrë në shqyrtim kërkesën e saj, përben edhe faktin e kundërligjshëm nga i cili paditëses i është shkaktuar dëm pasuror.

I vetmi diskutim në raport me pretendimet e paditëses, lidhet me faktin nëse nga fakti i kundërligjshëm, paditëses i është shkaktuar dëm moral përveç atij material. Dëmi moral i pretenduar nga paditësja ka të bëjë me cenimin e nderit dhe personalitetit, e drejtë kjo e mbrojtur nga neni 625 i K. Civil.

Në interpretim të nenit 625 të K. Civil, nën dritën edhe të interpretimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues Nr 12/2007, dëmi jo pasuror përfshin çdo lloj dëmi të pësuar nga cenimi i të drejtave dhe interesave jo pasurore, që bëjnë pjesë në vlerat e njeriut. Dëmi moral është shfaqje e brendshme e turbullimit të padrejtë të gjendjes shpirtërore të paditësit, dhimbje e vuajtje shpirtërore apo gjendje ankthi e mundimi shpirtëror që rrjedh si pasojë e faktit të paligjshëm.

Sipas të drejtës sonë civile, lidhur me ekzistencën e dëmit moral në formën e cenimit të nderit dhe dinjitetit, paditësi ka barrën e provës se ky dëm i është shkaktuar si pasojë e faktit të kundërligjshëm të të tretit. Duke ballafaquar faktet e ngjara në raportet ndërmjet paditëses dhe palës së paditur, me interpretimin ligjor të nenit 625 të K. Civil, paditësja nuk ka arritur të provojë se nga fakti i kundërligjshëm, asaj i është shkaktuar edhe dëm jo pasuror në formën e dëmit moral, përveç dëmit pasuror.

Fakti që paditësja ka ushtruar një funksion të rëndësishëm shtetëror, statusi i të cilit barazohet me statusin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, mbrojtja e posaçme që i garanton ligji për një periudhë të caktuar pas përfundimit të mandatit, mos realizimi i të drejtës për tu rikthyer në detyrën e gjyqtares së Gjykatës së Apelit, përveç humbjes pasurore nga mungesa e pagës së plotë për shkak të

funksionit, nuk mund te interpretohet si humbje jopasurore, në aspektin e shfaqjes së brendshme të turbullimit të padrejtë të gjendjes shpirtërore, dhimbje e vuajtje shpirtërore apo gjendje ankthi e mundimi shpirtëror. Nderi dhe dinjiteti i paditëses mbetet i pacenuar për gjatë kohës që ajo gëzon statusin e anëtares së KQZ, status i cili është mjaft i privilegjuar dhe i respektuar në shoqëri.

Për sa më sipër, ky kolegji vlerëson se kërkimi i paditëses për shpërblim dëmi jo pasuror është një kërkim i pabazuar në prova.

Në analizë të fundit, Gjykata Administrative e Apelit, çmon se vendimi i gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë duhet të ndryshohet pjesërisht duke pranuar vetëm kërkimin për shpërblim dëmi pasuror.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, në seancë gjyqësore, bazuar në nenin 53, germa "c", të ligjit Nr. 49 datë 03.05.2012 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*"

VENDOSI

- Ndryshimin e vendimit Nr. 7462, datë 17.12.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Pranimin e pjesëshëm të padisë.
- Detyrimin e palës së paditur, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, të dëmshpërblejë paditësen [REDAKTUAR] për dëmin pasuror të shkaktuar, duke i kompensuar pagën mbi pagën e përfituar në zbatim të nenit 7 të ligjit nr 8097 dt 23.03.1996, deri në nivelin e pagës referuese të funksionit si nënkryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për periudhën 01.01.2013 – 01.01.2016.
- Rrëzimin e padisë në kërkimet e tjera.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.

Ky vendim përben titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga përmbaruesi gjyqësor në rast mospërbushje vullnetare të detyrimit nga pala e paditur. Afati i përmbushjes së detyrimit është 6 muaj.

- Kundër vendimit lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë , sot më datë 16.03.2017

Anëtar
Amarildo LAÇI

Anëtare
Lindita SINANAJ

Kryesues
Bari SHYTI

Pjesërisht kundër

D.v

D.v

D.v

e njehsuar me originalin

Sekretare



Kancelari
Leonard Shyti


